



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 qershor 2023
Nr. ref.:RK 2207/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI61/23

Parashtrues

Hedie Bylykbashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr.137/2021] të 20 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme
të Republikës së Kosovës**

e përbërë nga:

Gresa Caka - Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hedie Bylykbashi nga Komuna e Prishtinës, e cila përfaqësohet para Gjykatës nga Zef Berisha (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr.137/2021] të 20 dhjetorit 2021, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesja e kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 14 mars 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 mars 2023, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 31 mars 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR.KI61/23 caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH.KI61/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesues), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 31 mars 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi dokumente shtesë, përkatësisht autorizimin specifik për Gjykatë, të përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës.
9. Më 24 prill 2023, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e përgjithshëm, të 18 marsit 2010, nëpërmjet së cilit parashtruesja e kërkesës e autorizonte atë për përfaqësim në të gjitha organet shtetërore. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e njoftoi Gjykatën se, parashtruesja e kërkesës ndodhet për trajtim mjekësor jashtë vendit, dhe prandaj ishte e pamundur të sigurohej autorizimi specifik për Gjykatë.
10. Më 25 maj 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 5 shkurt 2003, parashtruesja e kërkesës u suspendua nga detyra në regjistrimin e veturave, nga Administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë [në tekstin e mëtejme: UNMIK].

12. Më 6 prill 2004, parashtruesja e kërkesës dorëzoi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës [në tekstin e mëtejme: KPMK], kundër vendimit për suspendim nga puna.
13. Më 1 korrik 2010, KPMK-ja nëpërmjet Vendimit [nr.02 (28) 04], përfundoi procedimin administrativ të ankesës, për shkak të braktisjes dhe pamundësisë të realizimit të objektit të ankesës. KPMK-ja arsyetoi si në vijim:

“Komisioni i KPMK-së pas shqyrtimit të shkresave konstatoi se ankuesja nuk ka paraqitur interesim për ankesën e paraqitur më gjatë se 3 (tre) muaj. Kështu që duke u mbështetur në nenin 78 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative ku thuhet se: Procedimi konsiderohet i braktisur në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj ka qenë jo aktiv mbi 3 muaj me përjashtim të rastit ku ka interes publik për marrjen e një vendimi përfundimtar, si dhe konform me nenin 79 paragrafi 1 ku thuhet se: Procedimi administrative përfundon kur organi administrativ kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar konstaton se objekti për të cilën kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit ishte bërë I pamundur, vendosi që të përfundojë procedimin administrative të ankesës.”

14. Më 27 janar 2016, parashtruesja e kërkesës dorëzoi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë [në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore], kundër vendimit të KPMK-së.
15. Më 10 qershor 2019, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktgjykimit [A.nr.129/16], refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, me arsyetimin si në vijim:

“Kjo gjykata pasi ka administruar provat si më lart dhe vlerësuar të njëjtat një nga një ka gjetur se i padituri pasi i ka administruar provat dhe vlerësuar pretendimet ankimore ka dhënë arsyetim të bazuar me rastin kur ka vlerësuar se procesi i pamundur për ty vendosur sepse ankuesja nuk ka paraqitur interesim për ankesën e paraqitur më tepër se 3 muaj e njëjta nga momenti kur ka paraqitur ankesën nr.02(28)2004 të datës6.10.2004 dhe ka bërë plotësimin e ankesës me datë 25.10.2004 nuk ka treguar interesim për zgjedhjen e ankesës deri me datën 09.07.2009 prej më shumë se 4 viteve, duke u mbështetur në nenin 78 dhe nenin 79 të ligjit nr.02.L-28.”

16. Më 21 gusht 2019, parashtruesja e kërkesës dorëzoi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
17. Më 19 tetor 2021, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [AA.nr.699/2019], refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim:

“Kolegji i Gjykatës së Apelit, I shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet e paditëses, në ankesë konstaton se të njëjtat janë të pazuar në prova, të pazuar për tu ndryshuar gjendje faktike dhe për tu vendosur çështja në mënyrë tjetër, nga ajo e vërtetuar nga gjykatat e shkallës së parë në procedurë gjyqësore dhe nga organi administrative përfundimtar KMPSHCK, sepse nga të cekurat më lartë, si dhe aktgjykimi i shkallës së parë, vërtetohet se në këtë çështje juridike administrative të paditëses drejtë është vlerësuar ligjshmëria e aktit administrative përfundimtar në procedurë administrative dhe nuk është cenuar ligji në dëm të saj.”

18. Në një datë të panjohur, parashtruesja e kërkesës parashtrroi në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, nëpërmjet së cilës e kontestoi ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

19. Më 20 dhjetor 2021, Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit [ARJ.UZVP.nr.137/2021], refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

“Kjo Gjykata konsideron sit ë drejtë vendimin e gjykatave të instancës më të ulët e po ashtu vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm aktin e organit administrativ i cili ka mbështetje në nenet 78.1 dhe 79.1 të LPA-së nr.02/L-28 të cilët përcaktojnë se procedimi konsiderohet I braktisur në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë joaktive mbi 3 muaj, në përjashtim të rastit kur ka interesim publik për marrjen e në vendimi përfundimtar, dhe se procedimi administrative përfundon kur organi administrative kompetencë për marrjen e vendimit përfundimtar konstaton se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi [ARJ.UZVP.nr.137/21] i 10 marsit 2022 të Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij kushtetuese, të garantuara nga nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.
21. Parashtruesja e kërkesës fillimisht kërkon kthim në gjendje të mëparshme të afatit për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë, siç është përcaktuar përmes nenit 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit.
22. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar brenda afatit prej 1 (një) viti, sipas nenit 50 të Ligjit, duke arsyetuar vonesën për shkaqe shëndetësore të sëmundjes COVID-19.

Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”

Neni 50

(Kthimi në gjendjen e mëparshme)

“Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e 14 mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj”.

Rregullorja e punës

Rregulli 39

(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

*c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe
[...].”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 i të njëjtin nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
24. Gjykata më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, sipas paragrafit 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale), çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Sipas paragrafit 2 të të njëjtin nen, individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
25. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr.137/21] e 10 marsit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
26. Megjithatë, Gjykata po ashtu thekson se sipas nenit 49 (Afatet) të Ligjit, kërkesa duhet parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Kjo kërkesë është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
27. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin/[ARJ.UZVP.nr.137/2021] e 20 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme, të cilin e kishte pranuar më 14 mars 2022. Parashtruesja e kërkesës e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë, më 10 mars 2023. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses së kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajve të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht është e papranueshme për shqyrtim.
28. Megjithatë, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se kërkesën nuk e ka dorëzuar në Gjykata brenda afatit kohor të përcaktuar përmes nenit 49 të Ligjit, për shkak të sëmundjes me COVID-19. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, kërkesën e ka dorëzuar brenda 1 (një) viti, siç kërkohet me nenin 50 të Ligjit, dhe rrjedhimisht kërkon kthim të afatit në gjendje të mëparshme.
29. Në lidhje me kërkesën e parashtrueses së kërkesës për kthim të afatit në gjendje të mëparshme, Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e nenit 50 (Kthimi në gjendje e mëparshme) të Ligjit, i cili përcakton si në vijim:

“Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e 14 mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.”

30. Bazuar në përmbajtjen e nenit 50 të Ligjit, në mënyrë që të aprovohet kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme, duhet të plotësohen kushtet në vijim: (i) parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se pa fajin e tij/saj nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, përkatësisht afatit katër (4) mujor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit; (ii) parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës; (iii) parashtruesi i kërkesës duhet të arsyetojë kërkesën në fjalë; (iv) nuk ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me Ligj për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.
31. Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesja e kërkesës arsyeton vonesën e parashtrimit të kërkesës për shkaqe shëndetësore, dhe ia bashkëngjiti kërkesës një raport mjekësor. Gjykata vëren se, nëpërmjet këtij raporti dëshmohet që i autorizuari i parashtrueses së kërkesës, avokati Zef Berisha, ishte diagnostikuar me COVID-19, më 11 mars 2021, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte marrë pas 9 (nëntë) muajsh, më 20 dhjetor 2021. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se pa fajin e saj nuk ka qenë në gjendje ta parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar kohor. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk është përmbushur kriteri i parë ligjor, për kthim të afatit në gjendje të mëparshme.
32. Duke qenë se kriteret e përmendura më lart duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, Gjykata vlerëson se meqë nuk është përmbushur kriteri i parë, atëherë nuk është e nevojshme shqyrtimi i mëtejshëm. Gjykata konstaton se, në rastin konkret nuk janë përmbushur kriteret ligjore për kthim të afatit në gjendjen e mëparshme, siç përcaktohet nga neni 50 i Ligjit.
33. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI48/21, me parashtrues *Xhavit R. Sadrija*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 30 qershorit 2021, paragrafi 44; dhe KI45/21, me parashtrues *Samedin Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 majit 2021, paragrafi 35; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-se *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 10865/09,45886/07 dhe 32431/08, të 17 shtatorit 2014, paragrafi 258).
34. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se (i) kërkesa nuk plotëson kushtet e përcaktuara përmes nenit 50 të Ligjit për kthim në gjendje të mëparshme; dhe për pasojë (ii) kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes Aktgjykimit të kontestuar janë shkëlur të drejtat kushtetuese të parashtrueses së kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të neneve 27, 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (1) (c), 42 dhe 57 të Rregullores së punës, më 25 maj 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën e parashtrueses për kthim në gjendje të mëparshme, për sa i përket afatit për paraqitje të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese;
- II. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljatifi

Gresa Caka-Nimani

